



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
DREJTORIA E BURIMEVË NJERËZORE SHËRBIMEVE ARKIVËS DHE PROTOKOLLIT
NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORË

Lënda: Njoftim për shpallje për vend pune të lirë pune

Bazuar në VKM nr. 821, datë 6.12.2006 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në qendrat rezidenciale”, VKM nr. 850, datë 15.12.2006 “Për transferimin në pronësi disa bashkive të pronave të cilat janë në përgjegjësi administrimi të drejtorisë së përgjithshme të shërbimit social shtetëror dhe disa ndryshime në vendimin nr. 60, datë 1.2.2006 të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e listës së inventarit të pronave shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi shërbimit social shtetëror”;

Drejtor
në Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastrë,
Kategoria e pagës III-b.

Përshkrimi i vendit të punës

Drejtori drejton aktivitetin e përditshëm të institucionit

Të drejtat dhe detyrat e drejtorit janë:

- a) Drejtori përfaqëson ligjërisht institucionin.
- b) Drejton veprimtarinë e tij.
- c) Formulon rregullorën e brendshme dhe zbaton të gjitha udhëzimet dhe rregullorët e nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkia Gjirokastrë.
- d) Përgjigjet për mbarëvajtjen e institucionit, zbatimin e programeve për realizimin e qëllimeve dhe veprimtarive ekonomike-finaciare të institucionit.
- e) Mban lidhje dhe drejton e raporton për aktivitetin e institucionit, Bashkisë dhe SHSSH.
- f) Harton rregullat lidhur me disiplinën e punonjësve, bazuar në Kodin e Punës.
- g) Ka për detyrë të sigurojë mbarëvajtjen e marrdhënieve të stafit me të moshuarit.
- h) Mban dosjet e punonjësve dhe vulën e institucionit.

Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit

Kandidati që kërkon të punësohet në këtë vend pune duhet të plotësojë këto kritere:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të ketë përfunduar arsimin e lartë;
4. Niveli i edukimit /Master shkencor;
5. Të ketë eksperiencë pune mbi 5 vjet në profesion;

6. Të ketë aftësi për të zbatuar përgjegjësitë dhe realizimin e objektivave të institucionit;
7. Të jetë i përkushtuar dhe i komunikueshëm për zbatimin e detyrave;
8. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
9. Të mos jetë dhënë ndaj tij/saj masa disiplinore e largimit nga puna.

Kandidatët duhet të paraqesin brenda datës 16.11.2021, në Bashkinë Gjirokastrë në Protokoll, këto dokumente:

1. Kërkesën për aplikim;
2. Jetëshkrimi (CV);
3. Fotokopje të diplomës dhe listës së notave;
4. Fotokopje të librezës së punës;
5. Fotokopje të kartës së identitetit;
6. Dëshmi penaliteti ose vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
7. Çertifikatë familjare;
8. Vërtetim banimi;
9. Raport mjekësor që vërteton gjendjen shëndetësore;
10. Çertifikata të kualifikimeve;
11. Referenca pune.

Pas verifikimit paraprak në datën 17.11.2021, do të shpallet lista e konkurrentëve që do të vazhdojnë më tej konkurimin, si dhe data kur do të zhvillohet intervista me gojë.

Konkurimi do të bazohet në njohuri të përgjithshme mbi legjislacionin e Shërbimit Social Shtetëror, si dhe njohuri specifike për pozicionin e punës të cilat kanë të bëjnë me:

1. Njohuri mbi Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar;
2. Njohuri mbi Ligjin nr. 9355 “Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”, i ndryshuar;
3. Njohuri mbi Ligjin Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
4. Njohuri mbi ligjin 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;
5. Njohuri mbi Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;
6. Vendim nr. 821, datë 6.12.2006 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në qendrat rezidenciale”.

Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet më datë 23.11.2021, ora 10:00, në ambientet e Bashkisë Gjirokastrë.

Kandidatët fitues do të renditen sipas pikëve të marra dhe përzgjedhja e kandidateve për tu emëruar do të filloje nga kandidati fitues që ka marrë më shumë pikë.

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Gjirokastrë do të shpallë fituesit në faqen e internetit të Bashkisë Gjirokastrë dhe në stadat e informacionit të publikut. Kandidatët jo fitues kanë të drejtën e ankimit pranë Njësise së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Gjirokastrë.

Afati i ankimit është 5 ditë nga data e shpalljes së rezultateve të testimit.

Në përfundim të afatit të ankimit do të bëhet njoftimi i fituesit.